



KURTI, THIRRJE KFOR-it, EULEX-it DHE BE-së: SERBIA KA DISLOKUAR SISTEMET KUNDËRAJRORE NË AFËRSI TË KUFIRIT ME KOSOVËN

KURTI, THIRRJE KFOR-IT, EULEX-it DHE BE-së: SERBIA KA DISLOKUAR SISTEMET KUNDËRAJRORE NË AFËRSI TË KUFIRIT ME KOSOVËN



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë thirrje për një veprim të koordinuar ndërkombëtar kundër atyre që ai i quan akte agresioni nga Serbia. Në një deklaratë në "Facebook", Kurti ka kërkuar nga KFOR-i, EULEX-i dhe Bashkimi Evropian të dokumentojnë dhe të

publikojnë një raport që i atribuon Serbisë përgjegjësinë për veprimet që ai i kategorizon si terrorizëm ndaj Kosovës. Kurti, gjithashtu, shpreh dyshime për një riorganizim të grupit të Milan Radojiçiqit, duke lënë të kuptohet se ekziston rreziku i veprimeve të mëtejshme të

dhunshme. Edhe pas presionit ndërkombëtar, Kurti thotë se Serbia ende nuk ka tërhequr të gjitha trupat dhe artilerinë nga afërsia e territorit të Kosovës, duke theksuar se mungesa e sanksionimit të Serbisë rrit nivelin e kërcënimit në Ballkanin Perëndimor

AKTUALE



BULLGARIA GODITET NGA MOTI I LIG, DY TË VDEKUR | F. 2

ORARI I KUJDESTARISË, PROTESTOJNË DISA NGA BARNATORET NË KRYEQYTET | F. 6

TAHIRI: SHQETËSUES DRAFTI I STATUTIT TË ASOCIACIONIT, PO KRIJOHET NJË NIVEL I TRETË I PUSHTETIT | F. 3

EKONOMI



TREORËSHI PROBLEMATIK PËR ZHDOGANIMIN E MALLIT | F. 7

TAHIRI: BUXHETI I VITIT 2024 NUK PRODHON ZGJIDHJE, AAK-JA DO TË PARAQESË PESË AMENDAMENTE | F. 8

SPORT



SHQIPËRIA E MREKULLUESHME, SIGURON KUALIFIKIMIN NË KAMPIONATIN EVROPIAN | F. 10

ABDIXHIKU RIZJEDHET KRYETAR I LDK-së | FAQE 3



OSMANI: KOSOVA DHE SERBIA T'I MBYLLIN MOSMARRË-VESHJET | FAQE 6-7



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kievi dhe Moska, cak i sulmeve me dronë

KIEV, 19 NËNTOR - Si Kievi ashtu edhe Moska ishin cak i sulmeve me dronë të cilat gjerësisht u zbrapsën nga mbrojtjet ajrore në të dy shtetet, thanë autoritetet më 19 nëntor, duke mos raportuar për viktima. “Është zbrapsur një përpjekje nga regjimi i Kievit për të kryer sulm terrorist duke përdorur dron ndaj ndërtesave në Federatën Ruse”, tha përmes një deklaratë Ministria ruse e Mbrojtjes. Sulmet ukrainase me dronë në Moskë ishin të shpeshta gjatë pranverës, para se Ukraina ta

niste kundërofensivën e saj në qershor, por sulme të tilla kanë qenë të rralla në javët e fundit. Sipas Ministrisë ruse, droni ukrainas “u shkatërrua nga pajisja e mbrojtjes sonë ajrore... mbi territorin e qarkut urban të Bogorodskit”, në rajonin e Moskës. Kryetari i Moskës, Sergei Sobyenin, tha më vonë në Telegram se sulmi i penguar “nuk shkaktoi asnjë dëm apo viktima”. Ai tha se ekipet emergjente dolën në vendin ku ranë mbetjet e dronit të shkatërruar.

Edhe Kievi është goditur për të dytën natë me radhë nga një breshëri e dromëve Shahed, të prodhimit iranian, që u lëshuan nga forcat ruse, thanë autoritetet lokale. Autoritetet raportuan për “shtim” të sulmeve në kryeqytetin ukrainas. “Për natën e dytë me radhë, armiku ka sulmuar kryeqytetin me dronë”, tha Sergiy Popko, kreu i administratës ushtarake të qytetit. Dronët rusë “u lëshuan në disa grupe dhe sulmuan Kievin nga disa drejtime”, tha ai.



OBSH-ja thotë se 32 foshnja nuk janë evakuuar nga spitali më i madh në Gazë

GAZA, 19 NËNTOR - Ekipi i Kombeve të Bashkuara tha më 19 nëntor se 291 pacientë kanë mbetur në spitalin më të madh në Gazë, pasi trupat izraelite evakuuan pacientët e tjerë. Në mesin e atyre që kanë mbetur në spital janë 32 foshnja në gjendje jashtëzakonisht kritike, pacientë me plagë jashtëzakonisht të infektuara dhe ata që kanë lëndime në shtyllën kurrizore dhe nuk mund të lëvizin.

Ekipi i OKB-së ishte në gjendje të qëndronte në spitalin Shifa për një orë pasi pothuajse 2 500 persona të zhvendosur, pacientë që mund të lëviznin dhe stafi mjekësor, u larguan nga ndërtesa e spitalit mëngjesin e së shtunës, tha Organizata Botërore e Shëndetësisë, që udhëhoqi këtë mision.

OBSH tha se 25 pjesëtarë të stafit shëndetësor janë ende në spital, së bashku me pacientët. “Pacientët dhe stafi mjekësor, me të cilët kemi biseduar, ishin të tmerruar për sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe na u lutën për evakuim”, tha agjencia, duke e përshkruar Shifan si zonë të vdekjes. Kjo agjenci tha se edhe më shumë ekupe do të tentojnë të shkojnë në Shifa në ditët në vijim, në tentim për t'i evakuuar pacientët në jug të Gazës, ku spitalet, po ashtu,



janë të mbingarkuara. Izraeli për një kohë të gjatë ka pretenduar se Hamasi - grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - ka një qendër komanduese brenda dhe nën Shifa. Izraeli e ka përshkruar spitalin si cak kyç të luftës së tij për t'i dhënë fund sundimit të Hamasit në Gazë, pas sulmeve të grupit ekstremist në jug të Izraelit gjashtë javë më parë, sulme që nxitën luftën. Hamasi dhe stafi i spitalit mohojnë këto pretendime. Trupat izraelite që gjenden në spital për ditë të tëra po kryejnë

bastisje në ndërtesë. Trupat kanë pretenduar se kanë gjetur pistoletë dhe armë të tjera dhe u kanë treguar gazetarëve hyrjen e një tuneli, por këto pretendime të ushtrisë izraelite nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur. Largimet masive të shtunën nga spitali nga Izraeli u përshkruan si largime vullnetare. Por, OBSH-ja tha se ushtria kishte lëshuar urdhër për evakuim dhe disa prej të larguarve e përshkruan situatën si eksod me forcë.

Gjetkë në veri të Gazës, dhjetëra persona janë vrarë në kampin e refugjatëve Xhabalija ku, sipas

dëshmitarëve, një sulm izraelit goditi vendstrehimin e OKB-së të shtunën. Si pasojë e sulmit ajror u shkatërrua një shkollë në këtë kamp, thanë të mbijetuarit. Ushtria izraelite, që vazhdimisht u ka bërë thirrje palestinezëve të largohen nga veriu i Gazës, tha se trupat e saj ishin aktive në këtë zonë “me synim për t'i shënjestruar terroristët”.

Në jug të Gazës një sulm ajror izraelit goditi një kompleks banimi në Han Junis të shtunën, duke lënë të vrarë të paktën 26 palestinezë, sipas mjekëve në spitalin ku u dërguan viktimat.

Mbi 11 500 palestinezë janë vrarë, sipas të dhënave të paraqitura nga autoritetet shëndetësore palestineze. Edhe 2 700 të tjerë janë raportuar të zhdukur dhe të cilët besohet se kanë mbetur të bllokuar nën rrënoja. Në shifrat e viktimave, të paraqitura nga autoritetet shëndetësore në Gazë, nuk bëhet dallimi midis civilëve dhe luftëtarëve të Hamasit. Izraeli ka thënë se ka vrarë mijëra luftëtarë të Hamasit.

Ndërkaq, afër 1 200 persona janë vrarë në Izrael, shumica civilë, gjatë sulmeve të 7 tetorit të Hamasit. Hamasi, po ashtu, ka kapur pengje afër 240 persona. Ushtria izraelite ka thënë se gjatë luftës i janë vrarë 52 ushtarë.

Deri më tani Hamasi ka liruar katër pengje, Izraeli ka shpëtuar një dhe trupat e pajetë të dy pengjeve janë gjetur afër spitalit Shifa, zonë ku ka pasur luftime të ashpra.

Izraeli, ShBA-ja dhe Katari, i cili ndërmjetëson me Hamasin, kanë negociuar për javë të tëra për lirim të pengjeve. Të shtunën një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë sugjeroi se lirim i pengjeve duhet të përfundojë përpara se në Gazë e rrethuar nga Izraeli të hyjë ndihma humanitare për 2.3 milionë palestinezët që jetojnë në këtë territor.

Bullgaria goditet nga moti i lig, dy të vdekur

SOFJE, 19 NËNTOR - Dy persona kanë vdekur pasi erëra të fuqishme goditën Bullgarinë dhe Rumaninë të shtunën dhe të dielën. Shirat dhe reshjet e borës shkaktuan ndërprerje të energjisë elektrike dhe bllokuan apo vërshuan rrugët në lindje të të dyja shteteve, duke shtyrë Bullgarinë të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në rajonin

Varna në Detin e Zi. Një grua 43-vjeçare vdiq pasi e goditi një dru që u rrëzua në Varna mbrëmjen e së shtunës, ndërkaq dy pjesëtarë të emergjencës u lënduan, tha policia përmes një njoftimi. Një dru ra mbi një makinë që po kalonte në Sofje të shtunën, duke vrarë vozitësin 65 vjeç dhe duke lënduar rëndë gruan e tij, thanë autoritetet. “Moti i

lig rezultoi me humbje të jetës. Erërat e fuqishme dhe shirat e rrëmbyeshëm, në disa vende edhe reshje të borës, e bënë shumë të vështirë punën e ekupeve emergjente”, tha kryetari i Varnës, Blagomir Kotsev, të dielën, duke njoftuar për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe duke u bërë thirrje banorëve të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.



Shoqëria "Lëvizja" i jep mirënjohje veprimtarit Sali Bislimi

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, është nderuar me mirënjohje nga Shoqëria "Lëvizja" për kontributin e lirisë së Kosovës. Bislimi në "Facebook" ka thënë se ishte privilegj që këtë mirënjohje ta marrë nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, Isak Shabani, i cili ishte edhe bashkëpunëtor i heroit Zahir Pajaziti. "Sot kisha kënaqësinë të nderohem me mirënjohje nga Lëvizja për kontributin e lirisë së Kosovës. Ishte privilegj që këtë



mirënjohje ta marrë nga deputeti i Parlamentit të Kosovës, z. Isak Shabani, si mik dhe bashkëpunëtor i ngushtë i kryeherit Zahir Pajaziti! Lufta

e lirisë për Kosovën na obligonte bashkimin! Nder dhe respekt për mikun tim Ali Sheholli", ka shkruar Bislimi në "Facebook".



Abdixhiku rizgjedhet kryetar i LDK-së

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Lumir Abdixhiku është rizgjedhur të dielën kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Në Kuvendin e Dhjetë Zgjedhor, Abdixhiku mori drejtësinë e partisë më të vjetër në vend. Delegatët e LDK-së unanimisht votuan që Abdixhiku ta drejtojë partinë edhe për katër vjet. Ai nuk pati asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Abdixhiku ishte kandidati i vetëm për kryetar të LDK-së, pasi Faton Bislimit nuk iu aprovua kandidatura. "Kemi thënë se zgjedhjet në LDK janë festë. Janë festë sepse manifestojnë themelin e vetëbesimit tonë ideologjik. Atë të shprehjes e demokracisë, një vlerë e marrë si e mirëqenë për grupimin tonë politik, por më besoni më e domosdoshme sidomos në këtë kohë. Ky nivel i masivizimit demokratik është

shenjë e një thirrje të anëtarësisë si pritje e tyre ndaj secilit prej nesh. Së bashku kemi arritur ta bëjmë rrugën e ringritjes sonë të madhe, atë që e kërkonim të gjithë, atë që besonim se do ta gjenim të gjithë. E gjetëm sepse kemi ecur drejt. Na gjeti sepse kemi ecur mbarë", u shpreh Abdixhiku.

Ai ka shtuar se dy vjet e gjysmë më parë si parti u gjendën para një sfide të pazakontë, duke përmendur rezultatin më të dobët historik që LDK-ja e mori në zgjedhjet e vitit 2021. "Dy vjet e gjysmë qëndroj me bindje të plotë se kemi arritur rrugën e ringritjes sonë që besonim të gjithë. Na gjeti sepse kemi ecur mbarë", ka thënë Abdixhiku. Gjithashtu, është miratuar edhe programi "Rruga e Re" që është paraqitur nga kryetari i rizgjedhur i LDK-së, Lumir Abdixhiku. Programi u votua nga 333 delegatë sa ishin në sallë nga 335 sa janë gjithsej.



Tahiri: Shqetësues drafti i statutit të Asociacionit, po krijohet një nivel i tretë i pushtetit



PRISHTINË, 19 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, thotë se drafti i statutit të Asociacionit, i propozuar nga diplomatët euroamerikanë dhe i pranuar nga kryeministri Albin Kurti, është shqetësues për vendin. Sipas tij, përmes Asociacionit do të krijohet një nivel i tretë i pushtetit në vend, ku komuniteti serb në Kosovë do të ketë një nivel të madh të

vetëmenaxhimit. Tahiri thotë për "Kosova Press" se nga drafti që kanë parë dhe që është më i përafërt me draftin origjinal ka shqetësime serioze, pasi flitet për një shtrirje territoriale të komunitetit serb në Kosovë, për vetëmenaxhim të serbëve që formën e ka të Asociacionit, por përmbajtjen komplet tjetër. Tahiri duke kritikuar Kurtin për qasjen në dialog, thotë se ai është

kryeministri i parë që sjell një draft-statut për themelimin e Asociacionit. Krahas kësaj, Tahiri thekson se mostransparenca e Kurtit për Asociacionin është e papranueshme. Ndërsa shefi i deputetëve të PDK-së thotë se largimi nga agenda e dialogut të njohjes de jure ka rrezikuar kompromise të mëtutjeshme, përkundër që mund të themelohet Asociacioni.

Krasniqi dhe Ismaili vizitojnë Thaçin dhe Veselin në Hagë

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, me bashkëpartiakun Uran Ismaili, në fundjavë kanë vizituar ish-presidentin Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentarin Kadri Veseli.

Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se dyert e hekurta, korridoret e gjata e muret e larta çdo ditë e më shumë po e humbasin betejën kundrejt zemrave, besimit dhe kurajës së çlirimtarëve tanë. "I gjetëm të gjithë bashkë ballëllartë - si gjithmonë - dhe me Kosovën

në mendje e zemër, që vazhdon t'i frymëzojë, t'i mbajë të fortë e krenarë secilin. Gjithmonë me ta dhe pranë tyre, deri në ditën e shumëpritur të triumfit të drejtësisë! Sepse, dielli do të lindë përsëri!", ka shkruar Krasniqi.





MOS SANKSIONIMI I SERBISË RRRIT NIVELIN E KËRCËNIMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Kurti, thirrje KFOR-it, EULEX-it dhe BE-së: Serbia ka dislokuar sistemet kundërajrore në afërsi të kufirit me Kosovën

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë thirrje për një veprim të koordinuar ndërkombëtar kundër atyre që ai i quan akte agresioni nga Serbia. Në një deklaratë në "Facebook", Kurti ka kërkuar nga KFOR-i, EULEX-i dhe Bashkimi Evropian të dokumentojnë dhe të publikojnë një raport që i atribuon Serbisë përgjegjësinë për veprimet që ai i kategorizon si terrorizëm ndaj Kosovës. Kurti, gjithashtu, shpreh dyshime për një riorganizim të grupit të Milan Radojiçiqit, duke lënë të kuptohet se ekziston rreziku i veprimeve të mëtejshme të dhunshme. Edhe pas presionit ndërkombëtar, Kurti thotë se Serbia ende nuk ka tërhequr të gjitha trupat dhe artilerinë nga afërsia e territorit të Kosovës, duke theksuar se mungesa e sanksionimit të Serbisë, rrit nivelin e kërcënimit në Ballkanin Perëndimor

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të dielën se në Rashkë të Serbisë po ngjan riorganizimi paramilitar dhe terrorist i Millan Radojiçiqit dhe grupit të tij, me instruksione dhe mbështetje të shtetit të Serbisë. Sipas Kurtit, të premten e 10 nëntorit ai ka udhëhequr një takim me rreth 40 politikanë serbë e zyrtarë të komunave ilegale nga Kosova. "Në mbledhjen e mbajtur në shtëpinë e kulturës në Rashkë, ai kishte pranë Svetllana

Milladinov, zëvendësen e Petar Petkoviçiqit, koordinators të së ashtuquajturës zyrë të Serbisë për Kosovë. Gjatë këtij takimi, përveç deputetëve të Listës Serbe, kanë marrë pjesë edhe kryetari i ri i saj Zlatan Elek dhe nënkryetarët, Dragisha Milloviq dhe Dalibor Jevtiq. Aty është kërkuar mobilizim për votim të partisë-shtet në Serbi, SNS, në zgjedhjet e 17 dhjetorit. Ata që janë në listë të rrogave janë kushtëzuar me to, ndërsa për të tjerë janë ofruar vende pune në periudhë 3 dhe 6-mujore", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ai ka thënë se Millan Radojiçiq,

pas sulmit terrorist të kryer në veri, u lirua brenda ditës që ta vazhdonte veprimtarinë paramilitare e terroriste në shërbim të politikës shtetërore të Serbisë kundër Kosovës. "U bënë pesë muaj pas rrëmbimit në Leposaviq të policëve tanë kufitarë Rifat Zeka, Beqir Sefa e Shemë Mustafa dhe tetë javë nga vrasja e rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. KFOR-i, EULEX-i dhe BE-ja duhet të dalin me raport publik e zyrtar ku ia atribuojnë Serbisë aktin e agresionit dhe krimin e terrorizmit, dhe ku dënohet riorganizimi i grupit të

Radojiçiqit", ka deklaruar Kurti. Ai ka shtuar se edhe pas presionit ndërkombëtar, Serbia ende nuk i ka tërhequr të gjitha trupat dhe artilerinë nga afërsia e territorit të Kosovës. "Ajo vazhdon ta kërcënojë sigurinë e Republikës së Kosovës me bazat e përparme operuese të Forcave të Armatosura të Serbisë përgjatë kufirit me vendin tonë. Për më tepër, Serbia ka dislokuar sistemet kundërajrore në afërsi të kufirit me Kosovën. Kërcënimi nga Rusia dhe Serbia për stabilitetin, paqen dhe sigurinë rajonale po vërehet gjithnjë e më shumë. Rusia synon ndezjen e një vatre krize në oborrin e BE-së, për ta defokusuar NATO-n, kurse Serbia përmbushjen e ambicieve territoriale ndaj fqinjëve sipas projektit 'Bota Serbe' të Vulinit e të Vuçiçiqit", ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka theksuar se mungesa e sanksionimit të Serbisë rrit nivelin e kërcënimit në Ballkanin Perëndimor. "Drejtuesit e grupit terrorist, në vend se të jenë duke u përballur me drejtësinë në Kosovë, vazhdojnë përgatitjet për sulme të tjera ndaj Kosovës dhe

grumbullim të votave me shantazhe ndaj serbëve të Kosovës", ka thënë Kurti. Në Banjskë të komunës së Zveçanit grupe të armatosura serbësh sulmuan policinë e Kosovës më 24 shtator dhe vranë një polic. Në përlëshjen e armatosur që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë. Në ditët pas sulmit, Policia e Kosovës konfiskoi një sasi të madhe armësh në Banjskë, për të cilat tha se janë prodhim i fabrikave serbe dhe ish-jugosllave. Vetë Radojiçiqi, përmes një letre publike më 29 shtator, pranoi se "personalisht" ka organizuar rebelimin e armatosur në veri të Kosovës. Ai mohoi përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore të Serbisë në sulm. Ai, po ashtu, nuk i pranoi veprat me të cilat e ngarkoi Prokuroria e Beogradit. Radojiçiqi u lirua nga mbajtja në Serbi, por iu konfiskuan dokumentet. Sulmi në Banjskë nxiti shqetësime për qëndrueshmërinë në rajon, ndërsa bashkësia ndërkombëtare u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë t'u kthehen bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve.

Osmani: Kosova dhe Serbia t'i mbyllin mosmarrëveshjet



PRISHTINË, 19 NËNTOR - Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, konsideron se është e domosdoshme marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë pasi, siç thotë ai, po ndodhin ndryshime të shpejta në gjeopolitikë, të cilat nuk e favorizojnë Ballkanin.

Kryediplomati maqedonas në intervistën për "KosovaPress" thotë se në Ballkan ende mund të ketë sfida dhe tensione, andaj thekson se nevojitet vëmendje e veçantë. Ai ka folur edhe për draft-statutin për Asociacionin, ndërsa për sulmin terrorist në Banjskë, ku u vra rreshteri policor Afrim Bunjaku, tha se ka kthyer gjithçka në pikën zero. "Situata e sigurisë në Ballkan është ende me sfida. Nuk besoj që ka një kërcënim eminent për destabilizim. Kjo është në bazë të analizave që i bëmë si vende anëtare të NATO-s, edhe si kryesues i OSBE-së, dhe në bazë të të gjitha informacioneve bilaterale që kemi. Do të thotë në Ballkan nuk presim ndonjë destabilizim që mund të ndodhë, mirëpo sfida e tensione mund të ketë. Duhet një vëmendje e veçantë", thotë ai.

Për çështjen e sigurisë në Ballkan dhe rrezikun potencial së fundmi ka folur edhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy, sipas të cilit, "Rusia po përgatit një luftë në Ballkan". Osmani thotë se deklaratat e tilla janë mesazh plus pse duhet

të mbyllen me shpejtësi temat e mëdha. "Ne gjithmonë kemi qenë të vëmendshëm, eventualisht zgjerim të konfliktit në Ballkan. Ballkani ka dosje të hapura, të cilat janë, në një mënyrë, potencial për eskalim dhe sigurisht se ka aktorë të cilët do të kishin dashur ta defokusojnë opinionin botëror me një krizë të re dhe ky është një mesazh plus se pse ne duhet të ngutemi t'i mbyllim temat e mëdha këtu në rajon, që të mos lejojmë tokë pjellore për të gjithë ata aktorë malinj të cilët duan ta kenë Ballkanin territor rezervë për konflikte", thotë Osmani.

Si rrjedhojë, Osmani thotë se Kosova dhe Serbia duhet ta shfrytëzojnë momentumin për t'i përmbyllur mosmarrëveshjet. "Ju e dini se Maqedonia e Veriut ishte nikoqire e atij dialogu (marrëveshja e Ohrit) që flet shumë për interesin tonë që sa më shpejt të përmbyllen dallimet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pozicioni i Maqedonisë së Veriut është se ne e mbështetim një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet dy vendeve, të cilat në qendër do ta kenë njohjen e ndërsjellë, pastaj rrugëtimin euroatlantik të të gjithë rajonit. Inkurajojmë palët që të shfrytëzojnë këto momente të rëndësishme gjeopolitike dhe ta avancojnë procesin e bisedimeve dhe arritjen e marrëveshjeve sepse

kohët dhe gjeopolitika po ndryshojnë dhe mendoj se këto ndryshime nuk po shkojnë në favor të rajonit", thotë ai.

Përndryshe, thekson se çdo zvarritje do t'i dëmtonte palët në proces, por edhe gjithë rajonin. "Unë mendoj se nuk ka alternativë [për marrëveshjen finale Kosovë - Serbi]. Çdo zvarritje mendoj se i dëmton palët në proces. Gjeopolitika po ndryshon, rendi botëror po ndryshon, agresioni rus në Ukrainë ka thyer parimet bazë të arkitekturës së sigurisë në Evropë, dhe kjo sigurisht se nuk favorizon vendet e vogla në rajon. Prandaj, duhet t'i shfrytëzojmë këto momente të rëndësishme gjeopolitike, interesin e ShBA-së dhe Evropës që t'i mbyllim temat e mëdha për shkak se mendoj se e ardhmja nuk do të jetë e favorshme", thekson Osmani.

I pyetur për agresionin serb në Banjskë dhe masat e vëna ndaj Kosovës, kryediplomati maqedonas thotë se ajo që ndodhi më 24 shtator kërkon reflektim të Bashkimit Evropian dhe të vendeve të rajonit në mënyrë që më pas të mund të vazhdohet me dinamika të tjera. "Unë mendoj se ajo që ndodhi në Banjskë ishte një situatë kthimi, të asaj që kishte ndodhur deri atëherë, sepse na riktheu në pikën zero. Në atë se a ka ende aktorë në rajon, të cilët mendojnë për zgjidhje territoriale të çështjeve etnike.

Andaj, kjo ishte një çështje reflektimi, për të cilën duhet edhe Bashkimi Evropian, edhe ne vendet në rajon, fillimisht t'i adresojmë aktorët të cilët mund të kenë ambicie për zgjidhje territoriale të çështjeve etnike, pastaj të vazhdojmë me dinamika të tjera. Unë mendoj se është e domosdoshme të deeskalojë situata në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mendoj se koha e luftërave ka përfunduar. Ka dy alternativa: luftë ose paqe. Zona gri është shumë e rrezikshme. Prandaj, nëse vlerësojmë se luftërat në Ballkan kanë përfunduar, atëherë të vetmet alternativa që kanë mbetur janë pajtimi, mbyllja e çështjeve të hapura, bashkëpunimi, progresi i të gjitha vendeve drejt Bashkimit Evropian", thotë ai.

Sa i përket draft-statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, të cilin e ka pranuar kryeministri Albin Kurti nga emisarët euro-amerikanë, Osmani thotë se është çështje e Kosovës të vendosë për rregullimin e brendshëm. "Është çështje e autoriteteve të Kosovës që të vendosin për të ardhmen e Kosovës, për rregullin e brendshëm në Kosovë. Maqedonia e Veriut mund t'i japë vetëm mbështetje dhe inkurajim edhe palës së Kosovës, edhe asaj serbe, që ta vazhdojnë angazhimin drejt mbylljes së dallimeve sepse

këto po mbajnë peng zhvillimin e të dyjave shteteve dhe gjithë rajonit", thekson ai.

Kryediplomati maqedonas, njëherësh kryesues i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Bujar Osmani, ka treguar edhe sfidat me të cilat po përballen aktualisht. Porse ka shprehur optimizëm se do të mund të gjejnë një zgjidhje për vazhdimësinë e organizatës. "Unë shpresoj se po. Edhe pse OSBE gjendet në një fazë kritike, në një moment kritik të ekzistimit të vetë 50 vjet pas themelimit, na ka rënë neve mbi shpatulla që të merremi me këto çështje ekzistenciale të BE-së. Po bëjmë përpjekjet tona. Shpresojmë që këto 10 ditë të mbetura para Këshillit Ministror në Shkup të gjejmë zgjidhje për çështje të cilat po ngarkojnë mbi të ardhmen e organizatës. Unë kam për detyrë të kem shpresë dhe të jem optimist për shkak se jam kryesues i organizatës dhe po humba unë shpresën, atëherë sigurisht se nuk do të ketë asnjë shans për sukses", thotë ai derisa shton se katër liderët ekzekutivë të OSBE-së, të cilëve u skadon mandati, janë pjesë e paketës së bisedimeve me vendet participuese.

Samiti i OSBE-së do të mbahet më 30 nëntor dhe 1 dhjetor në Maqedoni të Veriut, ku edhe do të vendoset se cila do të jetë e ardhmja e organizatës.

Serbia, 48 baza ushtarake në kufi me Kosovën, Maqedonci: Bazat janë të drejtuara armiqësisht drejt territorit të Kosovës

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, foli për bazat ushtarake serbe që janë vendosur përgjatë kufirit, të cilat, sipas tij, përbëjnë rrezik. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, i pyetur në një intervistë për A2CNN se përse Kosova nuk arriti t'i bindë ndërkombëtarët që ta ndëshkojnë Serbinë për sulmin terrorist në Banjskë, tha se këtu ka të bëjë me një kalkulim politik të partnerëve. Sipas Maqedonci, mungesa e ndëshkimit të ashpër për Serbinë nga BE-ja dhe ShBA-ja ka qenë një lëvizje taktike për ta mundësuar vazhdimësinë e dialogut. "Unë mendoj se të gjithë partnerët ndërkombëtarë janë të bindur se, përveçse ky grup terrorist ka pasur synim për ndarje dhe aneksim të një pjese të territorit të vendit tonë, gjithashtu ka pasur edhe lidhje me strukturat shtetërore të Serbisë. Këtë e kanë thënë faktikisht ata që kanë deklaruar rreth çështjes së Banjskës. Besoj se është bërë një kalkulim politik nga bashkësia ndërkombëtare

në këtë rast. Një pjesë e partnerëve tanë kanë konsideruar të zhvillojnë një politikë më të butë në raport me Serbinë në këtë situatë, ndoshta nga këndvështrimi i tyre për ta mundësuar vazhdimin e dialogut", tha Maqedonci. Por rrjedha historike e ngjarjeve në Ballkan, sipas ministrit të Mbrojtjes së Kosovës, ka treguar përherë se Serbia ulet në tryezë dhe zbutet vetëm kur përdoret "forca". "Mirëpo ne kemi pasur në këtë rajon kurdoherë situata të tilla ku për Serbinë, i vetmi mjet për ta detyruar të ulet dhe të bëjë zgjidhje politike ka qenë forca. Unë mendoj se është dashur një reagim më i fortë. Është dashur t'i vendosen sanksione dhe është dashur t'i bëhet me dije Serbisë se kjo qasje hegemoniste dhe agresive ndaj fqinjëve nuk mund të prodhojë rezultat tjetër përveç atij si në Banjskë." Ministri i Mbrojtjes në Kosovë, Ejup Maqedonci, ka folur edhe për bazat ushtarake serbe që janë të vendosura përgjatë



kufirit me Kosovën, të cilat, sipas tij, përbëjnë rrezik. Ai tregoi se në këto baza, jo shumë larg territorit të Kosovës, janë të dislokuara 3 nga 4 brigadat e këmbësorisë serbe, teksa shtoi se shpërndarja taktike e tyre tregon se po presin momentin e duhur për të kryer një invazion. "48 bazat e ushtrisë serbe ekzistojnë përgjatë kufirit. Janë

në një distancë nga 300 m deri në 5 km brenda kufirit të Serbisë. Ato përbëjnë kërcënim. Bazat janë të drejtuara armiqësisht drejt territorit të Kosovës dhe janë 3 nga 4 brigadat e këmbësorisë serbe të vendosura në jug të Serbisë. Këto janë në një distancë të shkurtër nga Kosova. Këto tri brigada mbështesin 48 bazat

operacionale. Këto lloj bazash vendosen në vende ku pritet një invazion. Këto baza presin një moment të volitshëm për Serbinë për të kryer aksione ushtarake, apo për të mbështetur një sulm si ai i Banjskës. Janë diku 4 000 trupa në këto baza, të pajisura me armatim dhe mjete për sulme ushtarake", tha Maqedonci.

Rritja e rasteve me HIV/AIDS në Kosovë, Sadiku flet për hapjen e këshillimores së parë në Prishtinë

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Në vitet e fundit në Kosovë ka pasur rritje të numrit të personave të prekur nga HIV/AIDS. Për të ofruar këshilla dhe teste rreth sëmundjeve seksuale, në Prishtinë para disa ditësh është hapur edhe këshillimorja e parë për sëmundjet HIV/AIDS, Hepatit B dhe C dhe Sifilis. Qytetarët do të mund të marrin këshilla dhe të kryejnë testimet falas në këshillimore e cila gjendet në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Drejtori i Shëndetësisë në komunën e Prishtinës, Izet Sadiku, në një intervistë për "Telegraf"-in, ka thënë se



këshillimorja do të jetë e hapur nga dita e hënë deri të premtën, duke filluar nga ora 07:00 deri në orën 15:00. "Kemi arritur falë CDF-së që menaxhon fondet

globale, që janë fonde që jepen për HIV/AIDS, ku Kosova për vite të tëra përfiton nga grantet. Një nga qëllimet e këtij granti është ruajtja e shëndetit seksual

e të rinjve dhe tuberkulozi. Ne kemi arritur, bashkë me ta, të hapim këshillimoren e parë, e cila do të ketë për qëllim këshillimin dhe testimin falas për HIV/AIDS, HEPATIT B dhe C, dhe SIFILIS, që janë sëmundje shumë të shpeshta, sidomos te të rinjtë. Në këshillimore të gjitha shërbimet do të bëhen falas dhe të ruhet konfidencialiteti. Pra të gjitha shërbimet do të bëhen përmes një kodi", është shprehur ai. Gjithashtu, Sadiku bëri me dije se do ta rritin edhe numrin e profesionistëve shëndetësorë të angazhuar në këtë qendër. Duke folur për numrin e

personave të prekur nga HIV/AIDS në Kosovë, ai tha se vitet e fundit kanë vërejtur rritje të numrit të personave të prekur nga kjo sëmundje. "Kosova është vend që ka numër të ulët me HIV/AIDS, por kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi raste. Për arsye se HIV-i është një infeksion. Problematik është inkubacioni i zgjatur, koha mund të zgjasë me vite, deri 10 vjet. Një person mund të jetë i infektuar me HIV, por nuk e di, pra ai mund të jetë burim i infeksionit. Përmes këshillimoreve do të japim sa më shumë informata", tha Sadiku.

Orari i kujdestarisë, protestojnë disa nga barnatoret në kryeqytet

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Disa nga barnatoret në kryeqytet kanë protestuar të dielën në shenjë pakënaqësie lidhur me vendimin e komunës së Prishtinës për kujdestari. Sipas këtij vendimi, nga e hëna deri të shtunën pesë barnatore në gjithë kryeqytetin qëndrojnë të hapura gjatë natës. Ndërkaq, të dielën dhe festave janë dhjetë barnatore kujdestare. E barnatoret që kanë nisur protestën po kërkojnë që të ndryshohet ky vendim. "Në shenjë pakënaqësie për faktin se jemi vënë në pozitë të aktit të kryer, barnatoret e paraqitura në kërkesë do të

organizojnë protestë ditën e diel, datë 19.11.2023, duke i hapur barnatoret, por duke mos shitur barna, dhe atë çdo të diel deri në ndryshimin e kësaj rregulloreje dhe rikthimin e orarit të vjetër. Kjo shkresë është njoftim për protestë. Kjo rregullore ashpëron gjobat ndaj bizneseve-barnatoreve, prandaj është në kundërshtim me parimin kushtetues të proporcionalitetit në raport me dëmin që i shkaktohet shtetit, prandaj ankuesit presin që komuna të mos shqiptojë gjoba për protestën e organizuar nga barnatoret

ankuese", thuhet në shkresën e dorëzuar dy ditë më parë. Rreth një muaj më parë komuna e Prishtinës kishte marrë vendim për ndryshimin e rregullores për orarin e punës për barnatoret duke e kufizuar atë deri në orën 21:00. Pas orës 21:00 komuna e Prishtinës me rotacion kishte caktuar disa barnatore kujdestare të cilat do të ishin në dispozicion të qytetarëve gjatë natës. "Orari i kujdestarisë së natës për barnatore është prej orës 21:00 deri në 07:00, kujdestarojnë 5 (pesë) barnatore në gjithë kryeqytetin. Gjobiten me nga



300 deri në 1 000 euro personi fizik dhe nga 1 000 deri në 3 000 euro personi juridik nëse nuk i përmbahen orarit të

përcaktuar. Orari i barnatoreve kujdestare do të publikohet së shpejti", thuhej në njoftimin e komunës.

Treorëshi problematik për zhdoganimin e mallit

PRISHTINË, 19 NËNTOR - "Shoferët me vështirësi binden të dërgojnë mallra në Kosovë. Ata hezitojnë, sepse ndodh që mbeten pa pauzë e pa ushqim", thotë Nasuf Hoti, pronar i kompanisë "Delta Transport" me qendër në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Sipas tij, problem është koha e shkurtër - prej vetëm tri orësh - për të cilën shoferët e kamionëve me mallra duhet të arrijnë nga pika kufitare ku hyjnë në Kosovë deri te terminali për zhdoganimin e mallrave. Në të kundërtën, gjobiten.

Kosova ndan pika kufitare me katër shtete të rajonit: Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Malin e Zi.

Në pikat kufitare bëhet deklarimi i dërgesave komerciale që hyjnë në Kosovë dhe ato pastaj plumbohen ose mbyllen me dry derisa të arrijnë në njërin prej terminalëve të Doganës së Kosovës.

Dhjetë terminalët për zhdoganim, sipas Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, janë të vendosura në qytete të ndryshme të vendit, përfshirë: Prishtinën, Hanin e Elezit, Pejën, Mitrovicën e Jugut, Gjilanin, Prizrenin dhe Ferizajn. Më i madhi prej tyre është në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut, ku, sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, zhdoganohen 60 për qind e mallrave që importohen.

"Edhe shoferët kanë orar"

Afati prej tri orësh është "absurd" edhe për Ilir Saqipin, pronar i kompanisë "Ilirija-Transport" në Preshevë - pjesa jugore e Serbisë - që po ashtu transporton mallra në Kosovë. "Kur hyn në Kosovë, për shembull, kamioni futet në pikën kufitare të Dheu i Bardhë dhe duhet të shkojë në terminalin doganor në Pejë. Është problem të arrihet atje për tri orë, sepse mund të ndodhë të ketë ndonjë aksident në rrugë, pëlcet ndonjë gomë, ka kolonë...", thotë Saqipi për "Radion Evropa e Lirë".

Pika kufitare me Serbinë, Dheu i Bardhë, gjendet në komunën e Gjilanit, në juglindje të Kosovës, dhe është mbi 130 kilometra larg qytetit të Pejës, që gjendet në veriperëndim të Kosovës.

Arben Gashi, pronar i kompanisë



"Star Shped" nga Prishtina, ndan hallin e njëjtë me kolegët e vendeve fqinje. Ai thotë se shoferët shumë shpesh detyrohen ta bëjnë pauzën para se të hyjnë në Kosovë në mënyrë që të mos vonohen në terminal të zhdoganimit.

"Edhe shoferët kanë orar të punës sikurse punëtorët e tjerë". "Nëse ka ndonjë problem eventual, patjetër duhet të lajmërohet dogana. Në të kundërtën, gjobitesh", thotë Gashi për "Radion Evropa e Lirë". Besim Berisha, kryetar i Shoqatës së Transportuesve të Mallrave, që funksionon në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se "jo rrallëherë paraqiten raste kur transportuesit nuk arrijnë me kohë në terminal", por nuk specifikon më shumë në lidhje me gjobat e shqiptuara. Ai thotë se shoqata që drejton së shpejti do të bëjë kërkesë zyrtare tek institucionet kompetente që koha transitorie e mallit të zgjatet edhe për një orë, përkatësisht në katër orë. Sipas tij, kjo periudhë

do t'i eliminonte problemet e pretenduara të operatorëve ekonomikë.

Në rast vonese, 500 euro gjobë

Dogana e Kosovës lejon që zhdoganimi të bëhet në terminalin më të afërt nga pika e hyrjes në Kosovë, ose në terminalin më të afërt me selinë ku është e regjistruar kompania. Zëdhënësi i Doganës, Adriatik Stavileci, thotë se nëse operatorët ekonomikë nuk e respektojnë afatin prej tri orësh për arrijtjen nga pika kufitare në terminalin e zhdoganimit, një gjë e tillë konsiderohet shkelje. Por, nëse shoferët i paralajmërojnë vonesat dhe ato janë të arsyeshme, gjobat nuk aplikohen, sipas tij.

Me Kodin Doganor, gjobat për këto raste janë 500 euro.

Stavileci thotë se rastet e gjobitjes janë të rralla, sepse operatorët ekonomikë i lajmërojnë vonesat. Sipas Doganës, afati prej tri

orësh, i paraparë me një udhëzim administrativ, "është i mjaftueshëm" dhe në rast se kamionët nuk kanë ndonjë defekt, dërgesat mund të arrijnë në cilindo terminal nga cilado pikë kufitare.

Zyrtarë të Doganës nuk japin ndonjë përgjigje për arsyet e këtij afati kohor, që zbatohet prej vitesh, por ish-drejtori i këtij institucioni, Naim Huruglica, thotë se kjo kohë e rrit sigurinë e qarkullimit të mallrave. "Po e marr një shembull se ku mund të jetë rreziku... Dikush, ndoshta, ka deklaruar se ka një mall të lirë, material ndërtimor, por në realitet ka fshehur diçka brenda, dhe nëse nuk lajmërohet ose zhduket brenda tri orësh, ekziston dyshimi se ai është ndalur në ndonjë vend për ta ndërruar atë mall, ose për ta shkarkuar, ose për të bërë diçka", thotë Huruglica për "Radion Evropa e Lirë".

Për këtë arsye, thotë Huruglica, ankesat e pronarëve të kompanive transportuese janë të padrejta pasi, kujton ai, ata kanë

të drejtë ta zgjedhin terminalin më të afërt.

Madje, sipas tij, me gjendjen aktuale të rrugëve të Kosovës, treorëshi është afat optimal për të arritur në cilindo terminal. "Fakti që Dogana e ka limituar këtë në tri orë, ka synim që shoferëve të kamionëve të mos u lejohet devijimi i rrugës, apo të ndalen pa arsye... vetëm nëse ka ndonjë prishje ose diçka tjetër", thotë Huruglica.

REL-i ka pyetur institucionet në Maqedoni të Veriut dhe në Serbi se sa është në këto vende koha për zhdoganimin e mallrave sepse, sipas disa kompanive transportuese në Kosovë, atje arrijnë deri në 6 orë, por nuk ka marrë përgjigje.

Kosova importon shumicën e produkteve nga vendet fqinje ose ato të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2022, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave në vend, Kosova ka importuar produkte në vlerë mbi 5 miliardë euro, ndërsa ka eksportuar produkte në vlerë afër 1 miliard euro.

Tahiri: Buxheti i vitit 2024 nuk prodhon zgjidhje, AAK-ja do të paraqesë pesë amendamente

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se buxheti i vitit 2024 nuk parasheh efekte reale dhe as zhvillim të sektorit privat. Tahiri në "Facebook" ka paraqitur pesë amendamentet e AAK-së për Projektbuxhetin e vitit 2024. "Pesë amendamentet e AAK-së! Buxheti i vitit 2024 kaloi në

lexim të parë. Fatkeqësisht, ky buxhet nuk parasheh efekte reale as në pagat në sektorin publik, as në ekonominë dhe zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Grupi parlamentar i AAK-së i ka përgatitur pesë kërkesa konkrete për amendamentim që kanë dalë nga tryeza e 9: 1. Amendamenti i parë vjen nga përfaqësuesit e sindikatave të sektorit publik

për ngritjen e koeficientit nga 105 në 129 euro; 2. Amendamenti për Kontratën Kolektive; 3. Buxhetimi i Autostradës së Dukagjinit; 4. Amendamenti për Sigurimet Shëndetësore; 5. Vije buxhetore për rritjen e pensioneve", ka shkruar Tahiri, duke theksuar se gjatë kësaj jave do të zhvillojnë diskutim publik për amendamentet e tjera.

